



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AGJENCIA E PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 249 Prot.

Tiranë, më 31.03 2017

Lënda: Njoftim

Njoftohen të gjithë Autoritetet Kontraktore se, në kuadër të ndryshimeve dhe përmirësimeve të bëra në Sistemin e Prokurimit Elektronik (në vijim "SPE") është shtuar funksionaliteti i krijimit të Regjistrit të Parashikimeve dhe Realizimeve të Prokurimit Publik.

Agjencia e Prokurimit Publik (në vijim "APP") ka marrë masat që regjistrat e parashikimeve për vitin 2017, të dërguara për publikim pranë APP, të cilat kanë qenë të plotësuara me të gjitha të dhënat sipas Udhëzimit Nr. 2, datë 27.01.2015 "*Për hartimin e Regjistrit të Parashikimeve të Prokurimit Publik dhe Regjistrit të Realizimeve të Prokurimit Publik*", të krijohen automatikisht në sistem për secilin autoritet kontraktor.

Megjithatë, gjatë procesit të importimit të këtyre të dhënave të dërguara në formë elektronike nga Autoritetet Kontraktore, janë vërejtur mangësi në plotësimin e informacionit të kërkuar sipas udhëzimit të sipërcituar.

Sa më sipër, APP njofton të gjithë Autoritetet Kontraktore se, menjëherë pas vendosjes në funksion të sistemit me ndryshimet e reja, duhet të kryejnë në SPE verifikimin dhe përditësimin të gjithë zërave të regjistrit (elementet e regjistrit) përkatës të parashikimeve të prokurimit publik, për vitin 2017.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin tuaj,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Eduard Ahmeti